



## THIRRJE PËR APLIKIM PËR EKSPERT TË JASHTËM

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 468, datë 03. 06.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive, të katit përdhes, katit të parë dhe të dytë të godinës me emërtimin **Atelier për dekorin e Radio – Televizionit**”, ka kaluar në përgjegjësi administrimi të Autoritetit të Mediave Audiovizive ndërtesa e ish Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, e cila do të përshtatet për ambiente për zhvillimin e aktivitetit të AMA-s, Tiranë”. Autoriteti Kontraktues (AMA), kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm, Konsulent/Arkitekt të kualifikuar, i cili do të merret me arredimin e hapësirave të brendshme të godinës së Autoritetit të Mediave Audiovizive.

### TERMAT E REFERENCES

#### Objekti

Konceptim, Kompozim dhe Arredim i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të godinës së Autoritetit të Mediave Audiovizive me një dizajn praktik, tërheqës dhe funksional.

#### Detyrat

Eksperti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive, për realizimin e detyrave të mëposhtme:

- Me kërkesë të AMA-s dhe në bashkëpunim të ngushtë me stafin, eksperti Konsulent/Arkitekt do të angazhohet të kryej konceptimin, kompozimin dhe arredimin e hapësirave të brendshme të godinës së AMA-s, në mënyrë estetike praktike dhe funksionale për stafin e Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- Të japë propozime rreth mobilimit Hidrosanitar, përzgjedhja e të gjitha pajisjeve dhe aksesoreve sanitare.
- Të japë propozime për elemente dekorative në interior si: gjelbërim i brendshëm, emërtime të ambienteve etj.
- Të japë ide për dekorimin e hollit të ndërtesës.
- Të japë ide për dekorimin e zyrave (në bashkëpunim të ngushtë me stafin)
- Të japë ide për dekorimin e elementeve ndarëse të disa zyrave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Autoriteti Kontraktues (AMA) do t'i sigurojë ekspertit të gjithë informacionin/ dokumentet e nevojshme për t'u njohur nga eksperti me qëllim përmbushjen e detyrave të mësipërme.

**Periudha e zbatimit të detyrave:**

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë për një periudhë dy mujore.

Në rast nevoje, dhe me kërkesën e arsyetuar me shkrim të parashtruar nga eksperti, Autoriteti Kontraktues (AMA) mund të zgjasë periudhën e zbatimit të kontratës. Çdo zgjatje e kontratës do të jetë subjekt i performancës së mire nga ana e ekspertit. Kjo do të gjykohet, në veçanti në drejtim të progresit drejt arritjes së qëllimit të shërbimit.

**Kualifikimet dhe aftësitë e ekspertit:**

- Një dokument zyrtar i lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, të licencuar sipas dispozitave në fuqi;
- Eksperienca të mëparshme në formulim të detyrave të ngjashme;
- Aftësi organizuese, planifikim dhe përmbushje e afateve.

**Produktet dhe materialet**

Eksperti do të paraqesë në gjuhën shqipe të gjitha propozimet, rekomandimet, dokumentet e hartuara në AMA.

**Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda këtij afati pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive.**

**Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë**

**APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 6 MARS, 2017**